

KËRKESË
Nr.4132/3, datë 3.8.2009

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Krum-Golaj”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.872, datë 12.12.2007 dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.138, datë 23.3.2000.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

Pronari i listës bashkëlidhur do të kompensohet për efekt shpronësimi, pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

Vlera totale e këtij shpronësimi është 2 680 766 (dy milion e gjashtëqind e tetëdhjetë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE,
TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
Sokol Olldashi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
RRETHI: HAS
KOMUNA: GOLAJ
FSHATI: LETAJ

LISTA EMËRORE E PRONARIT QË SHPRONËSOHET
NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “KRUM-GOLAJ”

Nr.	Pronari			Z.K.	Nr. Pas	Truall			Objekt Vlera lekë	Vlera totale lekë	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri			Sip.m ²	Çmimi lekë/m ²	Vlera lekë			
1	Petrit	Bajram	Cuni	2431	1	133	1370	182210	2498556	2680766	Konfirmuar nga ZRPP
						133		182210	2498556	2680766	